

## **Vendim nr. 90 datë 30.04.2024**

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Elsa Toska, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Sonila Bejtja, anëtarë, në datën 30.04.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 2 (Sh) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUESE:** **SHOQËRIA “STAR CONSTRUCTION”**, përfaqësuar me avokat Ilir Dode, me autorizim.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-1425, datë 14.09.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 7, 42, 43, 131, pikat 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N:**

#### **I**

#### **Rrethanat e çështjes**

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr. 4528/2022 në ngarkim të shtetasit S. Ll., administrator i subjektit “Llanaj ndërtim” sh.p.k., për veprën penale të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal (*KP*), në bazë të kallëzimit penal nr. 3031-

S, datë 06.05.2022, të paraqitur nga shoqëria “Star Construction” sh.p.k. (*kërkuesja*), përfaqësuar nga administratori i saj, A.A.

2. Në vijim, organi i akuzës ka dërguar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë kërkesën për vendosjen e sekuestros preventive për objektin strukturë I, për banim dhe shërbim 2, 9, 11 kate dhe strukturë II, për banim dhe shërbim 2 dhe 9 kate, me 2 kate parkim e shërbime nëntokë të përbashkët, ndërmjet rrugëve “Ndre Mjeda” dhe “Babë Rexha”, në pronën e shoqërisë “Ofiçina e automjeteve të tregtisë” sh.a., shoqërisë “Parku i automjeteve” sh.a. dhe P. G. Këto objekte kanë zhvilluese shoqëritë “Star Construction” sh.p.k., “Llanaj ndërtim” sh.p.k. e shtetasin P. G., si dhe subjekt ndërtues shoqëritë “Star Construction” sh.p.k., pasuri këto të ndodhura në rrugën “Ndre Mjeda”, zona kadastrale nr. 8220. Pas vendimmarrjes së gjykatës së shkallës së parë, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka njoftuar Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) për të bërë shënimet përkatëse në regjistrat kadastralë, pasi dyshohej se ishte kryer vepra penale “Mashtrimi”, e parashikuar nga neni 143/3 i KP-së nga personi nën hetim S. Ll., si administrator i subjektit “Llanaj ndërtim” sh.p.k.

3. Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë rezulton se është regjistruar edhe procedimi penal nr. 4684/2019 për veprat penale të parashikuara nga nenet 143/3 dhe 180/1 të KP-së. Ky procedim ka për bazë kallëzimet e shtetasve S. Ll. dhe A. A., adresuar njëri-tjetrit, të cilat janë ndjekur nga prokurorja që ka në ngarkim edhe procedimin penal nr. 4528/2022. Në rrethanat e mësipërme procedimet penale janë bashkuar në një procedim të vetëm me nr. 4684/2019, si procedim penal i regjistruar më parë.

4. Sipas kallëzimit penal të kërkueses, shtetasi S. Ll. është administrator dhe ortak i vetëm në dy shoqëri “S.L.L-2010-Llanaj” sh.p.k. dhe “Llanaj ndërtim” sh.p.k. Ndërmjet kërkueses dhe shoqërisë “Llanaj ndërtim” sh.p.k. është lidhur kontratë bashkëinvestimi në ndërtim nr. 527 rep., nr. 145 kol., datë 27.01.2014, ku objekt i saj është bashkëpunimi për investim në objektin 9 e 11 katësh, ku kërkuesja ka të drejtën ekskluzive të veprojë si ndërtuese, sipërmarrëse dhe përfaqësuese kundrejt palëve të treta. Ndërkohë, pala tjetër kontraktore, sipas kontratës, do të marrë përsipër që me shpenzimet e veta të realizojë 100% karabinanë e objektit, ku vlera e punës së kryer do llogaritet si pjesë e investuar në shoqëri si bashkëinvestitor. Në pikën 11 të kësaj kontrate parashikohet se të ardhurat që do të krijohen me kontratëporositë e klientëve, gjatë fazës së ndërtimit deri në përfundim të objektit, do të përdoren për financimin e objektit dhe vetëm kur të

jetë realizuar ky detyrim, atëherë shoqërive u lind e drejta të bien dakord të ndajnë fitime në vlerë monetare sipas përcaktimit në këtë kontratë.

5. Në datën 08.05.2015 është nënshkruar anekskontrata nr. 2313 rep., nr. 909 kol., sipas së cilës objekti do të ndërtohej me palë zhvilluese kërkuesen, shoqërinë “Llanaj ndërtim” sh.p.k. dhe shtetasin P. G. I kallëzuar S. Ll., si administrator dhe ortak i vetëm i Shoqërisë “Llanaj ndërtim” sh.p.k. nuk ka përmbushur detyrimet në investim sipas parashikimeve në kontratë dhe projekti ka vazhduar nga kërkuesja me mundësitë e veta financiare.

6. Referuar akteve të fashikullit hetimor nr. 4648/2019, shtetasi S. Ll. ka arkëtuar të ardhura nga persona të tretë, konkretisht vlerën e apartamenteve, njësave të shërbimit etj., në kundërshtim me parashikimet kontraktuale. Po kështu, sipas kallëzimit penal të kërkueses, shtetasi S.Ll., në cilësinë e administratorit të shoqërisë “Llanaj ndërtim” sh.p.k., ka lidhur 100 kontrata dhe ka arkëtuar për shoqërinë e tij 4.500.000 euro dhe 37.000.000 lekë, të cilat në fakt duheshin arkëtuar pranë shoqërisë ndërtuese sipas përcaktimeve të kontratës së bashkëinvestimit. Veç kësaj, subjekti “Llanaj ndërtim” sh.p.k. nuk ka përmbushur detyrimet e tij për ndërtimin e karabinasë në masën 84%, ka braktisur investimin dhe ka goditur gjyqësish faturat tatimore dhe situacionet e përgatitura nga kërkuesja, duke kontestuar vlerën e detyrimit të përcaktuar sipas tyre dhe duke mos paguar as detyrimin e pranuar. Ndërkohë, ai ka arkëtuar të ardhurat e marra nga klientët, me të cilët është lidhur kontratë prenotimi.

7. Pas shqyrtimit të kërkesës së prokurorisë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 2357, datë 11.11.2022, ka vendosur pranimin e kërkesës për vendosjen e sekuestros preventive mbi objektin, Strukturën I për banim dhe shërbim 2, 9, 11 kate dhe strukturën II, banim dhe shërbim 2 dhe 9 kate, me 2 kate parkim e shërbime nëntokë, të përbashkët, ndërmjet rrugëve “Ndre Mjeda” dhe “Babë Rexha” në pronën e shoqërisë “Ofiçina e automjeteve të tregtisë” sh.a., shoqërisë “Parku i automjeteve” sh.a. dhe P. G. me zhvillues kërkuesen, “Llanaj ndërtim” sh.p.k., P. G. dhe subjekt ndërtues kërkuesen, pasuri të ndodhura në rrugën “Ndre Mjeda”. Gjykata ka urdhëruar, gjithashtu, ASHK-në për të bërë shënimin përkatës në regjistrat kadastralë. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim i kallëzuar S. Ll. dhe shtetasit M. R., R. J., E. H. dhe L. R.

8. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1120, datë 23.12.2022, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, për sa i përket masës së sekuestros preventive, duke shtuar se një pjesë e njësave të banimit, objekt i kontratave të sipërmarrjes t’u lihen në

përdorim porositësve shtetasit R. J., E. H., M. R. dhe L. R., me arsyetimin prokuroria ka marrë si person nën hetim shtetasin S. Ll., si të dyshuar për kryerjen e veprës penale, të parashikuar nga neni 143/3 i KP-së, duke evidentuar 106 familje si viktime të kësaj vepre penale. Një procedim i tillë nuk mund të derivojë në pasoja të tilla ligjore edhe për subjektet porositëse, pasi një situatë e tillë do të përkeqësonte edhe më tej pasojat e kësaj vepre penale. Kundër këtij vendimi, në datën 10.05.2023, kërkuesja ka ushtruar rekurs.

9. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00–2023–1425, datë 14.09.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai nuk plotësonte kushtet formale për t’u pranuar, pasi kërkuesja nuk legjitimohet për të paraqitur rekurs kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë.

10. Kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) në datën 16.01.2024 me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar me dokumentet e kërkuara, bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 02.02.2024. Në vijim, Kolegji i Gjykatës në datën 15.04.2024 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve.

## II

### Pretendimet e kërkueses

11. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në drejtim të:

11.1. *Së drejtës së pronës private (së drejtës së posedimit) të lidhur me moskrijimin e drejtë të ndërgjyqësisë*, të garantuar nga nenet 41 dhe 42 të Kushtetutës, pasi në ndryshim nga kërkesa e prokurorisë, ku kërkohet vendosja e sekuestros preventive në regjistrat e ASHK-së, gjykatat e faktit kanë vendosur, në mungesë të saj si palë ndërgjyqëse, marrjen e së drejtës reale të posedimit, si pjesë integrale dhe përbërëse e së drejtës së pronësisë, duke ia kaluar atë personave të tretë, me të cilët kërkuesja nuk ka asnjë marrëdhënie kontraktore. Gëzimi i pronës private është cenuar dukshëm nga vendimi i gjykatës së apelit, i cili është marrë pa praninë e kërkuesit si palë ndërgjyqëse, sikurse edhe në gjykimin e zhvilluar në gjykatën e shkallës së parë. Shkelja e kryer nga gjykatat e faktit është mbështetur

haptazi nga Gjykata e Lartë, e cila ka cenuar, gjithashtu, të drejtën e kërkueses për të gëzuar pronat, ndërkohë që asnjë subjekt tjetër veç saj nuk ka pasur të drejta reale të posedimit për këto pasuri të paluajtshme.

- 11.2. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykatat e faktit kanë abuzuar me të drejtën procedurale, në kushtet kur në një proces penal gjykohen konflikte civile. Kërkesa e prokurorisë është deformuar që në gjenezë, duke e ndryshuar atë nga një kërkesë për sekuestro preventive në regjistrat e ASHK-së, në një garë civile për fitimin e të drejtave reale, pa praninë e mbajtësit të së drejtës. Nga ana tjetër, Gjykata e Lartë i ka vlerësuar të drejta vendimmarrjet e tyre edhe pse kërkuësja nuk ka qenë palë në këto gjykime. Kjo gjykatë ka disponuar me vendim mospranimi ndaj rekursit të kërkueses, me arsytimin se ajo nuk mund të bëjë rekurs, pasi nuk ka qenë palë në gjykim. Kjo gjykatë ka arsyetuar, gjithashtu, se edhe nëse ajo do të kishte qenë palë në gjykim, vendimi i gjykatës së apelit ishte i drejtë, pasi pasuritë e paluajtshme i janë dhënë në përdorim personave që kanë lidhur kontratë sipërmarrjeje. Në kundërshtim me sa arsyeton Gjykata e Lartë, këta persona kanë lidhur kontratë vetëm me të hetuarin S. Ll., por jo me kërkuesen si subjekt ndërtues.

### III

#### Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

##### A. Për legjitimitimin e kërkueses

12. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual në çdo rast duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e

veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

13. Lidhur me legjitimimin *ratione personae*, Gjykata ka pohuar se, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individi duhet të provojë interesin e tij, si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial. Kjo, sepse individi, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejta, si dhe të provojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga masa/akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në çështjen konkrete kërkuessa ka pretenduar se i është cenuar e drejta e pronës nga vendimmarrja e gjykatës së apelit, e cila ka disponuar se një pjesë e sendit të sekuestruar (disa apartamente) me vendim të gjykatës së shkallës së parë i lihet në përdorim katër shtetasve, që ishin porositës të tyre. Sipas kërkuesses, shkelja nuk është riparuar as nga Gjykata e Lartë.

15. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se procesi penal është vënë në lëvizje bazuar në kallëzimin penal të kërkuesses. Gjatë këtij procesi penal, me kërkesë të prokurorit, gjykata e shkallës së parë ka caktuar masën e sekuestros preventive për pronën, e cila është një masë sigurimi në procesin penal që kufizon disponimin e lirë të pronës, duke kaluar administrimin e saj si rregull tek organet shtetërore. Në këtë kuptim, Mbledhja e Gjyqtarëve thekson se vendimi i caktimit të sekuestros, ndonëse me karakter të përkohshëm dhe që nuk vendos për themelin e çështjes, ndërhyt në të drejtën e pronës deri në dhënien e një vendimi të mundshëm për konfiskimin e pasurisë (*shih vendimin nr. 29, datë 16.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, kërkuessa nuk rezulton të ketë ngritur pretendime në ankimin kushtetues individual ndaj vendimit të sekuestros, për të cilin legjitimimi i saj procedural dhe substancial nuk do të vihej në dyshim. Madje këtë vendim ajo nuk e ka ankimuar as në gjykatën e apelit. Kërkuessa ka zgjedhur të paraqesë rekurs dhe në vijim, edhe ankim kushtetues individual ndaj vendimit të gjykatës së apelit, në pjesën që ka disponuar lënien e një pjese të sendit në përdorim të të tretëve. Lidhur me këtë vendimmarrje të gjykatës së apelit, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuessa nuk ka argumentuar

se si kalimi i së drejtës së përdorimit të një pjese të sendit të sekuestruar (pra në administrim të organeve shtetërore) tek të tretët sjell pasoja të drejtpërdrejta dhe reale në të drejtën e pronës. Kjo e fundit i është kufizuar kërkueses nga vendimi i caktimit të sekuestros, për të cilin ajo nuk ka asnjë kundërshtim.

16. Për sa më lart, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se kërkuesja nuk legjitimohet *ratione personae*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues.

17. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash<sup>12</sup>,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

---

<sup>1</sup> Gjyqtarja Sonila Bejtja votoi pro legjitimitetit *ratione personae* të kërkueses. Ndërkohë që, sipas saj, pretendimi për të drejtën substanciale të pronës, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës nuk është haptazi i pabazuar. Për këto arsye, në konsideratë të qasjeve të fundit të mbajtura nga Gjykata për çështje të tilla, kjo kërkesë duhej të ishte trajtuar në seancë plenare (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 18, datë 19.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

<sup>2</sup> Gjyqtarët Elsa Toska, Ilir Toska dhe Marjana Semini votuan për moskalimin e çështjes në seancë plenare, pasi vendimet objekt kundërshtimi janë jopërfundimtare dhe nuk mund t’i nënshtrohen gjykimit kushtetues, qëndrim ky i mbajtur dhe i elaboruar në mendimin paralel të vendimit nr. 18, datë 13.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese.